
	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

## Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe Tërheqjes

Hartoi	Miratoi
Menaxheri i Cilësisë	Drejtori

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

## 1.FUSHA E ZBATIMIT

Ky dokument informon në lidhje me procedurën e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Zgjerimit, Pezullimit dhe Tërheqjes dhe bazohet në standardin ISO / IEC 17024 : 2012, si dhe në kërkesat specifike të kompetencës që duhet të plotësojnë aplikantët në përputhje me Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet Elektrike, miratuar nga Ministri i Industrisë dhe Energjetikës me Nr. 3403/1 Prot. datë 30.06.2003,

## 2 REFERENCA

Standardi S SH ISO/IEC 17024 : 2012, Vlerësimi I konformitetit – Rregulla të përgjithshme për organizmat që operojnë në certifikimin e personit.

## 3. PËRSHKRIMI


### 3.1 Procesi i aplikimit

Kandidati apo subjekti paraqesin një kërkesë për tu certifikuar si personel elektrik. Hapi i parë është informimi i tyre nga vlerësuesi paraprak në lidhje me procedurat e certifikimit dhe dokumentat përkatës për të qene i certifikuar, tarifat si dhe dokumentat që ai duhet të dorëzojë pranë Austrian Institute of Excellence për aplikim.

Kandidati/Subjekti konsiderohet se ka aplikuar për certifikim pasi plotësuar formularin e aplikimit FM 01, si dhe ka dorëzuar gjithë dokumentacionin i cili është listuar në këtë formular për tu bashkëlidhur .

Kandidati nënshkruajnë formularin e aplikimit, i cili përban :

- Informacion të detajuar për identifikimin e e tij , si : emër, mbiemër, atësia, datëlindja, edukimi, eksperiencia, adresa, dhe skema e certifikimit
- Fushën e certifikimit

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

- Akt- marrëveshjen , në të cilën përcaktohen kërkesat për certifikim, të drejtat dhe detyrimet e personelit të certifikuar

Në rastet kur lejohet nga ligji në dokumentacionin mund të përdoret dhe nënshkrimi elektronik dhe është i pranueshëm.

Aplikanti merr përsipër vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

Në momentin e aplikimit , subjekti bashkë me dokumentacionin paguan dhe tarifën.

Aplikanti informohet nga Organizmi Austrian Institute of Excellence , mbi mundësinë për të deklaruar nëse ka arsye apo kërkesa apo nevoja specifike, në lidhje me vendin ku do të kryhet procesi i ekzaminimit teorik dhe praktik.

Vlerësuesi paraprak brenda 10 ditë pune nga momenti i dorëzimit të aplikimit , verifikon dokumentacionin nëse është në përputhje me kriteret e përcaktuar në skemën e certifikimit, dhe informon kandidatin mbi kualifikimin apo mos kualifikimin e tij.


Kandidatët që kualifikohen duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në procedurën e grupeve teknike PT 07.

Në rastet kur kandidati kualifikohet njoftohet nga vlerësuesi paraprak brenda 2 ditëve për datën dhe vendin ku do të zhvillohet ekzaminimi teorik dhe praktik.

Gjithë procesi nga aplikimi deri ne njoftimin e kandidatëve kryhet brenda 12 ditëve.

Nëse kandidatët e refuzuar nuk janë dakord me vendimin, ata mund të ankimohen apo apelojnë, në përputhje me procedurën e ankimit/apelimit që publikohet dhe në faqen zyrtare të Austrian Institute of Excellence.

Vlerësuesi paraprak e kalon dosjen tek Drejtuesi i Austrian Institute of Excellence, i cili në varësi të grupit që te kualifikimit per aplikantët, procedon me përzgjedhjen dhe miratimin e dy

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

ekzaminuesve. Ekzaminnuesit e përzgjedhur duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuar në Tabelën e Stafit të Trupit Certifikues .

### 3.2 Procesi i Vlerësimit

Kandidati njoftohet për planin e ekzaminimit sipas formës FM – 14. Në rastet kur ka komente apo kundërshtime ai i drejtohet Organizmit të paktën një javë para provimit, në rast të kundërt procedohet me ekzaminimin sipas planit.

Ekzaminuesit e përzgjedhur para procesit deklarojnë nëse kanë konflikt interesash me kandidatin apo subjektin. Në rast se po, Drejtori merr masat për zëvendësimin e tyre. Ky proces rregjistrohet në një dokument të vecantë dhe ruhet nga Menaxheri i Cilësisë.

Në planin e ekzaminimit përfshihen ekzaminimi i të gjitha llojet e testimit, që mund të jenë teorik dhe praktik. Ekzaminimi teorik kryhet në ambientet e Austrian Institute of Excellence, ndërsa praktik në raste specifike mund të kryhet dhe në ambientet e punës së subjektit, vetëm në qoftë se plotësohen kriteret logjistike për realizimin e sigurt të certifikimit. Këto kritere janë të përshkruara në Checklisten CL02 Listë Kontrolli për Pajisjet.


Kriteret e ekzaminimit garantojnë saktësinë e vendimmarrjes për kalueshmërinë krahasueshmërinë e rezultateve të çdo testimi, në aspektin e përmbajtjes si dhe të vështirësisë duke përfshirë saktësinë e vendimit të kalimit/moskalimit të testimit nga aplikanti.

Për të garantuar administrimin konsistent të procesit të egzaminimit ndiqet me saktësi procedura e egzaminimit dhe dokumentohet me anë të dokumentacionit përkatës.

Kriteret për administrimin e procesit të testimit janë të përshkruara në Checklistën CL03\_Listë Kontrolli Për Administrimin E Ekzaminimit\_V1\_PN. Kriteret përfshijnë edhe ndricimin, ndarjen e kandidatëve, sigurinë e kanidatëve, zhurmën, etj.

AIEx është përgjegjëse për parandalimin e praktikave të mashkrimit/kopjimit gjatë egzaminimit duke marrë masat e mëposhtme:

**AIE – Austrian Institute of Excellence**  
 Rruga e Dibrës, Kompleksi Halili, 1017 Tiranë, Albania  
 Tel: +355 (0) 4 2 419 552 | Mobile: +355(0) 68 20 50 673,  
 E-mail: [projects@aie.al](mailto:projects@aie.al) Web: [www.aie.al](http://www.aie.al)

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

- a) kandidatët nënshkruajnë një deklaratë për zotimin e tyre për të mos publikuar informacionet konfidenciale të marra gjatë testimit dhe për të mos kopjuar.
- b) gjatë testimit, ka gjithmonë një vigjilent, rolin e të cilit mund ta luajë edhe koordinatori.
- c) identiteti i kandidatëve duhet të konfirmohet me anë të mjeteve të identifikimit të cilat duhet ti paraqesin gjatë ekzaminimit.
- d) ndalimi i personave të paautorizuar gjatë testimit
- e) monitorimi i procesit të ekzaminimit


Ekspertët e fushës specifike kryejnë hartimin e testeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Paisjet dhe Instalimet Elektrike. Testet hartohen sipas Procedura e ekzaminimit dhe hartimit testeve – PT 02.

Organizmi Austrian Institute of Excellence merr masat që procesi i ekzaminimit teorik dhe praktik të kryhet në kushte korrekte dhe të sigurta, në mënyrë që të mos çënohet vërtetësia e rezultatit. (Kontrolli bëhet nëpërmjet një checkliste nga koordinatori.)

Në rastet kur Austrian Institute of Excellence, merr në konsideratë vlerësimin e një trupe tjetër duhet të verifikojë nëse raportet, të dhënat dhe rregjistrimet janë ekuivalente me ato të përdorura nga Austrian Institute of Excellence, dhe janë hartuar sipas skemës së certifikimit.

Ekzaminuesit kryejnë fillimisht procesin e vlerësimit teorik, më pas kalohet në vlerësim praktik. Në përfundim të dy proceseve , ekzaminuesit hartojnë një procesverbal ku përcaktohet nëse kandidati është kualifikuar apo skualifikuar, duke argumentuar vendimin për të dy rastet duke u bazuar në skemën e vlerësimit.

Në procesverbal përcaktohet dhe të dhëna për skemën e certifikimit, dhe grupin ku kualifikohet kandidati.

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

Gjithë të dhënat që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit teorik dhe praktik, ruhen në kushte që garantojnë sigurinë e tyre me kodifikimin përkatës. Të drejtë aksesit ka Drejtori i certifikimeve dhe koordinatori i certifikimeve.

Gjatë procesit të ekzaminimit merren masa që të ruhet distanca midis kandidatëve, për të shmangur komunikimin midis tyre, kushtet ambientale dhe qetësia të jenë të siguruar.

Organizmi përdor për ekzaminimin e procesit pasijet e tij, të cilat janë të përcaktuar në Listën e Paisjeve – FM 15. Për pajisjet që do të kërkohet kalibrim, AIE do të ndërmarrë kalibrimin e tyre.

Austrian Institute of Excellence përdor metodologji dhe procedura të përshtatshme (mbledhja dhe mirëmbajtja e statistikave), në mënyrë që të garantojë besueshmërinë, vlefshmërinë, dhe performancën për çdo aktivitet duke kryer kontrole në intervale të arsyeshme.


### **3.3 Vendimarrja**

Pas përfundimit të procesit ekzaminuesi, i përcjell koordinatorit të Austrian Institute of Excellence dosjen e kandidatit ku përfshihen procesverbali i ekzaminimit, vendimi i vlerësuesit paraprak, formulari i aplikimit dhe gjithë dokumentacioni, i cili duhet të jetë i bashkëlidhur sipas kërkesave në formular.

Në rastet kur ka ankesa apo apeline, bashkëlidhet në dosje dhe ky informacion.

Në përputhje me dokumentacionin, koordinatori i Austrian Institute of Excellence konfirmon plotësinë e dokumentacionit me anë të formularit FN10 dhe e kalon dosjen tek Vendimmarrësi i cili kryen vlerësimin teknik.

Vendimarrja për certifikimin, mirëmbajtjen, pezullimin, reduktimin apo tërheqjen nuk nënkontraktohet.

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

Vendimarrësi i Austrian Institute of Excellence, i cili ka përgjegjësinë për vendimarrjen e certifikimit të kandidatit nuk është i përfshirë në asnjë hap të procesit të vlerësimit apo trajnimit të kandidatëve.

Vendimarrësi i Austrian Institute of Excellence ka edukimin dhe eksperiencën e duhur për vendimarrjen në certifikimin e personelit elektrik. Ai plotëson kriteret e përcaktuara në Procedurën Struktura Përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin.

Për çdo certifikim Vendimarrësi Austrian Institute of Excellence plotëson formën Austrian Institute of Excellence – FN 10 .

Certifikata është pronë e kompanisë Austrian Institute of Excellence dhe ka formatin A4 dhe nënshkruhet nga Drejtori i Trupit Certifikues.


Vlefshmëria e certifikimit është e përcaktuar në programin specifik të secilit certifikim në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet e aplikueshme.

### **Certifikata**

Certifikata në përputhje me standardin ISO / IEC 17024 : 2012 dhe Udhëzimin Nr 17. i Fletores Zyrtare 2015 Nr 65 për Llojin, Përmbajtjen, Formatin Dhe Procedurën E Dhënies Së Dokumenteve Të Certifikimit Për Kursantët Në Sistemin E Formimit Profesional, në përputhje me ligjin nr. 8872 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

8. Certifikata përmban këto elemente:

- a) Emrin dhe kodin identifikues të institucionit ofrues të formimit profesional që lëshon certifikatën;
- b) Një identifikim unik certifikate
- c) Të dhënat personale të kursantit që përfton certifikatën, përfshirë: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, si dhe kodin identifikues;

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

- c) Fotografinë e personit që certifikohet
- d) Të dhënat për kursin e formimit (emërtimi, kohëzgjatja);
- dh) Referencë të standardit dhe skemës për të cilën certifikohet
- e) Të dhëna për kategorinë
- ë) Rezultatet e kursit në bazë të njësive mësimore (module, lëndë, tema, projekte etj.);
- f) Rezultatet e provimit përfundimtar (nëse aplikohet);
- g) Datën e lëshimit të certifikatës;
- gj) Afati i vlefshmërisë
- h) Emrin dhe pozicionin e personit nënshkrues të autorizuar prej institucionit përkatës të formimit profesional;
- i) Vulën e institucionit. Austrian Institute of Excellence merr masa që certifikata të jetë e pafalsifikueshme. Të gjithë personat e certifikuar nënshkruajnë një aktmarrëveshje për përdorimin e certifikatës sipas FM – 21.

### **Pezullimi , Tërheqja, Reduktimi i fushës së certifikimit**


Pezullimi, tërheqja, dhe Reduktimi i fushës së certifikimit aplikohet në dy raste.

#### **Pezullimi**

Vetë personi i certifikuar bën kërkesë për pezullim, tërheqje apo reduktim të fushës. Ekzaminuesit e Austrian Institute of Excellence, pasi vlerësojnë kërkesën, përcaktojnë kohën e pezullimit, të cilën ia komunikon dhe Vendimmarrësit. Vendimmarrësit merr vendimin përfundimtar dhe ja përcjell Menaxheri të Cilësisë për ta reflektura në listën e personave të certifikuar.

Në rastin e vetëpezullimit kur kalon periudhën 2 mujore, atëherë fillon procedura e tërheqjes së certifikimit.



	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

Pezullimi mund të kërkohet dhe nga Austrian Institute of Excellence në rastet kur konstatohet se personi i certifikuar nuk plotëson kriteret e certifikimit dhe ka shkelur akt- marrëveshjen e nënshkruar me Austrian Institute of Excellence.

Në bazë të informacionit që mund të merret nga ekzaminuesit, vlerësuesi praparak, apo ankesa për shkelje të kriterëve të certifikimit, Vendimarrësi i Austrian Institute of Excellence, brenda 5 ditësh nga dorëzimi i informacionit merr vendimin përfundimtar, të cilin ia komunikon personin apo subjektit duke përcaktuar edhe motivet. Organizmi ka të drejte të apelojë brenda 10 diteve pas marrjes së vendimit, në përputhje me Procedurën e ankesës/ apelimeve.


Vendimarrësi vendimin e pezullimit ja përcjell Menaxheri të Cilësisë për ta reflektura në listën e personave të certifikuar. Në rastin e pezullimit kur kalon periudhën 2 mujore, atëherë fillon procedura e tërheqjes së certifikimit.

#### Kushtet e Pezullimit

- Ka ankesa apo verejtje në lidhje me aktivitetin e personave të certifikuar , por ato lidhen me kompetencën e personit të certifikuar ;
  - Mosplotësimi i detyrimeve financiare që personi apo subjekti i certifikuar i kanë Austrian Institute of Excellence;
  - Mosnjohim për ndryshime të ndodhura në aftësitë apo kushte që çënojnë kompetencën e personit të certifikuar.
  - Refuzimi i vizitave verifikuese pa arsye.

Bazuar në akt – marrëveshjen e nënshkruar personit të cilit i është pezulluar certifikata apo tërhequr certifikata nuk duhet ta përdorë ate, apo të përdorë referenca të saj.

Në rastet kur personi i certifikuar , kërkon ti rikthehet procesit të certifikimit ai argumenton motivet e tij dhe i bën një kërkesë Austrian Institute of Excellence për të rifilluar aktivitetin .

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

Duke ju referuar kushteve të Pezullimit apo Tërheqjes, Austrian Institute of Excellence bën një verifikim të kriterëve nëse nuk ka cënim të kriterëve dhe personi plotëson kushtet dhe ka aftësitë, ekzaminuesit i komunikojnë Drejtorit që personi mund ti kthehet statusi i certifikuar.

Nëse pezullimi ka ndodhur për arsye financiare pas shlyejres së tyre, i riktheet statusi i certifikuar me vendim të Vendimarrësi të Austrian Institute of Excellence.

#### 4. TËRHEQJA.

Si në rastin e pezullimit, edhe për tërheqjen ka dy raste, kur kërkohet nga vetë personi apo kur aplikohet nga Austrian Institute of Excellence.

Dhe në rastin e vetëtërheqjes zbatohet e njëjta praktikë si në rastin e vetëpezuullimit


Tërheqja mund të kërkohet nga Austrian Institute of Excellence në këto raste:

- Nëse personi i certifikuar nuk plotëson kriteret brenda afatit të pezullimit, Austrian Institute of Excellence i tërheq certifikimin personit për një periudhë 3 mujore;
- Shkelje të kushteve të akt – marrëveshjes;
- Mospërmbushje e detyrimeve financiare ;
- Kur ka humbur aftësitë për të qenë person i certifikuar në përputhje me kriteret e skemës së certifikimit.;
- Ka një vendim gjyqësor të formës së prerë ;

Vendimi për tërheqje i komunikohet Trupës, ndërsa Koordinatori e heq nga lista e personave të certifikuar dhe njofton menaxherin e cilësisë.

#### 5. REDUKTIMI

Vetë personi mund të kërkojë reduktim të fushës së certifikimit të kalojë p.sh në një grup më të ulët , për arsye të humbjes së aftësive teknike, apo vështirësi financiare. Vetë personi I

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

certifikuar bën kërkesë për reduktim të fushës. Vendimarrësi merr vendimin përfundimtar dhe ja përcjell Menaxheri të Cilësisë për ta reflektuar në listën e personave të certifikuar.

Mund të kërkohet nga Austrian Institute of Excellence, kur personi konsiderohet i paaftë për të qenë pjesë e kategorisë që është certifikuar . Si burime mund të shërbejnë ankesa të subjektit apo personave të cilët kanë marr shërbime nga personi i certifikuar. Vendimarrësi merr vendimin përfundimtar dhe ja përcjell Menaxheri të Cilësisë për ta reflektuar në listën e personave të certifikuar.

Personi i certifikuar njoftohet gjithashtu mbi këtë vendim, dhe ka të drejtë që të ankohet apo apelojë në përputhje me procedurën e ankimit dhe apelimit.

## 6 RICERTIFIKIMI

Personi i certifikuar , i cili dëshiron të ricertifikohet duhet që 1 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë , të depozitojë kërkesën për ricertifikim.

Me kërkesë të veçantë dhe me arsyetimin me shkrim për vonesën e aplikimit organizmi certifikues mund të pranojë aplikime të marra pas datës së skadencës.

Personit do ti kërkohen dokumenta shtesë në rastet kur janë konstatuar ndryshime të skemës së certifikimit, por dhe vetë personi ka ndryshime në klasifikimin e kategorisë.

Gjatë procesit të ricertifikimit merren parasysh ndryshimet në


-Kërkesat e standardit, rregullave apo legjislacionit kombëtar në lidhje me skemën e certifikimit.

-Natyra dhe rëndësia e industrisë ku punon personi i certifikuar.

-Risqet që mund të vijjnë nga ricertifikimi i personave jo- kompetent

-Ndryshimet në teknologji

-Kërkesat nga palët e interesuara

	<b>Procedura e Certifikimit, Ricertifikimit, Reduktimit, Pezullimit dhe tërheqjes</b>	PT .01
		Data 27.02.2018
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 2	

-Frekuenca dhe përmbajtja e aktivitetit mbikqyrës, nëse kërkohet nga skema e certifikimit.

Procesi i ricertifikimit duhet të kryhet në mënyrë të paanshme dhe të sigurojë që vlerësimi është i paanshëm dhe garantohet konfirmimi dhe vazhdimësia dhe kompetenca e personave të certifikuar.

Në rastet kur kërkesa për ri – certifikim vjen nga një person i certifikuar nga një tjetër organizëm, do të kryeht verifikimi nëse kriteret dhe rregullat e përdorura në certifikimin e tij të mëparshëm janë të njëjtat me ato të përcaktuara nga Austrian Institute of Excellence për skemën e certifikimit të Personelit Elektrik.

Në rastet kur verifikohet që kanë ndryshime këto kërkesa, personi do ti nënshtrohet certifikimit fillestar.

## 7. LEGJENDA E NDRYSHIMEVE

Nr. Rishikimit	Seksioni i rishikuar	Detaje të rishikimit	Autori	Datë
Versioni 2	I gjithë dokumenti.	Përditësim dhe aktualizim i procedurës për të garantuar paanshmërinë në maksimum, dhe për të plotësuar të gjitha kriteret për trupat certifikues sipas ISO 17024.	Menaxheri I Cilësisë Bianca Duro	27.02.2018